

# KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Durrës, sot më datën **20.05.2022 (Dymijë e njëzetë e dy)**, lidhet kjo Kontratë për Shitblerjen e Kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “FUSION” sh.p.k, ndërmjet:

## **Shitësit:**

**Znj. Keti Ozaj**, e bija e Igli dhe Aishe, lindur në Tiranë më datë 02.12.1983 dhe banuese në adresën: Rruga "Vaso Pasha", Pall.17, Shk.1, Ap.89, Durres, shtetase shqiptare, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me anë të letërnjoftimit **Nr.036371229 dhe Nr.Personal: I36202055W**, duke patur pelqimin edhe te Bashkeshortit te saj **Z. Almand Kareçi**, i biri i Avni dhe i Liri, lindur ne Shijak me date 10.05.1982 dhe banuese në te njejten adresë, identifikuar me anë të letërnjoftimit **Nr.036371425 dhe Nr. Personal: I20510099D**.

*Dhe*

## **Blerësit:**

**Shoqëria “SUMMERTIME” sh.p.k**, me numër unik identifikimi të subjektit NUIS: M21525503D, me seli në Durres, me adresë Lagja 15, Rruga Aleksander Goga, Tek Ish magazinat e NT Durrës, përfaqësuar nga administratori **Z. Matteo Fortin**, i biri i Lorenzo dhe i Laura, shtetas italian, lindur ne Padova (PD), i datëlindjes 13.04.1979, banues në adresën: Masera Di Padova, Rruga "San Benedetto" N.19, identifikuar nga Pasaporta Nr. YB5121614, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar.

## **Kushte te Pergjithshme:**

1. Shitësi, **Znj. Keti Ozaj** është ortak i vetëm me 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “FUSION” sh.p.k, regjistruar pranë QKB me NUIS L02117502L me adresë: Lagja Nr.15, Rruga “A. Goga” tek ish Magazinat e NT, Durrës.
2. Blerësi, **Shoqëria “SUMMERTIME” sh.p.k** është subjekt tregtar i së drejtës shqiptare, me formë ligjore të organizimit “*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*”, e themeluar dhe regjistruar në regjistrin tregtar më datën 25.03.2022 me NUIS: M21525503D, me objekt të aktivitetit “*Shitje dhe blerje pronash, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, blerje aksionesh dhe titujsh të shoqërive të tjera.....*”

## **Neni 1**

- 1.1 Shitësi i shet kuotën e zotëruar prej tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë “FUSION” sh.p.k Blerësit, i cili pranon t’ a blejë atë, sipas kushteve dhe në masën e përcaktuar më poshtë në këtë Kontratë.

## **Neni 2**

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës në zotërim dhe pronësi të Shitësit, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë “FUSION” sh.p.k është në vlerën 2.600.000 (dy milion e gjashtëqind mijë lekë), vlerë e cila përbën edhe totalin e vlerës nominale të kuotës së kësaj shoqërie.
- 2.2 Çmimi i shitjes së këtyre kuotave është shlyer plotesisht nga Blerësi, ne llogarinë e Shitësit prane Intesa Sanpaolo Bank siç provohet nga mandati bankar dhe palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me këtë fakt.
- 2.3 Në këtë mënyrë, Blerësi **Shoqëria “SUMMERTIME” sh.p.k** bëhet ortak i vetëm i 1 (një) kuote me

100% të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të Shoqërisë "FUSION" sh.p.k.

### Neni 3

- 3.1 Me shitjen e kësaj kuote, përbërja e ortakëve të Shoqërisë "FUSION" sh.p.k. ndryshon dhe bëhet si vijon:  
- **Shoqëria "SUMMERTIME" sh.p.k** zotëron 1 (një) kuotë, e cila perfaqëson 100% të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar te Shoqërisë "FUSION" sh.p.k.

### Neni 4

- 4.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate për shitjen e 1 (një) kuote që perfaqëson 100% të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të Shoqërisë "FUSION" sh.p.k., Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja.

### Neni 5

- 5.1 Shitësi në lidhje me kuotën që transferohet nepermejt kësaj kontrate shitblerje deklaron, se nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj, apo që ti kenë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të, deri në datën e sotme.  
5.2 Shitësi i'a shet këtë kuote të kapitalit themeltar të shoqërisë, Blerësit, të lire nga çdo detyrim, barrë, apo pretendim nga të tretët.  
5.3 Të drejtat mbi kuotën e shitur nëpërmjet kësaj kontrate, nuk janë të përfshira në procese civile, penale administrative, arbitrazhi, apo të çfarëdo lloji natyre tjetër, që të mund të jetë shkak për cenimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi kuotën.

### Neni 6

- 6.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

### Neni 7

- 7.1 Në rast mosmarrëveshje midis Palëve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, përfundimin apo zbatueshmërinë e kësaj Kontrate, Palët do të takohen dhe përpiqen në mirëbesim të zgjidhin, sa më shpejtë që të jetë e mundur, mosmarrëveshjen në fjalë. Nëse kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**KONTRATA u hartua në 2 (dy) faqe dhe në 4 (katër) ekzemplar me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plote e të lirë e nënshkruajnë pa vërejtje.**

## PALËT KONTRAKTUESE

**SHITESI**  
KETI OZAJ

*Keti Ozaj*  
*Ozaj keti*

**Miratimi i Bashkëshortit**

Almand Kareçi

*ALMAND KARECI*  
*Kareci*

Përktheu:



*Sokol Meza*

**BLERESI**

Shoqëria "SUMMERTIME" SH.P.K  
Administratori  
Matteo Fortin

*Matteo Fortin*  
**SUMMERTIME**  
MIPT: M215255030